

Të nderuar prindër dhe nxënës të ardhshëm

Shkolla SHMQSH „DIMITAR VLLAHOV” Shkup, ekziston më shumë se 7 dekada dhe ka traditë të edukon kuadër në më shumë drejtime, për të cilën dëshmi janë edhe njerëz të profesionalizuar në këto lëmi që kanë dalë nga shkolla jonë. Shkolla përgadit kuadër për nevojat e tregut të punës të cilat janë të përgatitura për të hapur biznes personal ose punësim në kompanitë e ndryshme. Statistikat tregojnë që pas kryerjes një numër i madh i nxënësve punësohen.

Në shkollë janë të përfshira drejtimit dhe profilet në vijim:

1. Drejtimi: Shërbime personale

- Teknik i përkujdesjes kozmetike dhe bukurisë – arsim katërvjeçar (gjuhë maqedone dhe shqipe)
- Floktar – arsim trevjeçar (gjuhë maqedone, shqipe dhe turke)
- Estet për kujdes të këmbëve dhe duarve – arsim trevjeçar (gjuhë maqedone dhe shqipe)

2. Drejtimi kimiko-teknologjik

- Teknik i ushqimit – arsim katërvjeçar (gjuhë maqedone dhe shqipe)
- Përpunues i qumështit - arsim trevjeçar (gjuhë maqedone)
- Përpunues i mishit - arsim trevjeçar (gjuhë maqedone dhe shqipe)
- Mishtar- arsim dyvjeçar (gjuhë maqedone)

3. Drejtimi i grafikës

- Redaktor-dizajnues grafik – arsim katërvjeçar (gjuhë maqedone)
- Tipograf - arsim trevjeçar (gjuhë maqedone dhe shqipe)
- Përpunues i prodhimeve grafike - arsim trevjeçar (gjuhë maqedone)

Mësimi realizohet në gjuhë maqedone, shqipe dhe turke, programe me dizajn modular të cilat realizohen nga kuadër profesional për mësim teorik dhe praktik. E obligueshme është edhe trajnimi te punëdhënësit, me të cilët shkolla jonë ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi.

Përparësitë e shkollës janë:

Profile mësimore moderne dhe perspektive;
Realizimi i mësimit praktik në kabinete dhe hapësira të pajisura moderne;
Programe mësimore trevjeçare dhe katërvjeçare;
Vizitë dhe bashkëpunim me kompani të rëndësishme nga lëmia;
Mundësi për vazhdim të arsimit në institucionet për arsim të lartë dhe
Kuadër mësimor kualitativ

Të nderuar prindër dhe nxënës të ardhshëm

Në vijim janë përgatitjet për regjistrimet që na presin në shkollën tonë SHMQSH „Dimitar Vllahov” Shkup, në afatin e qershorit. Për këtë shkak duam të Ju përkujtojmë për kushtet, afatet dhe dokumentet e nevojshme për regjistrim në shkollën tonë.

Paraqitja dhe regjistrimi i parë i nxënësve kryhet me **16 dhe 17 qershor 2020**, kurse listat ranguese me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen me **18 qershor 2020**.

Paraqitja dhe regjistrimi i dytë i nxënësve kryhet me **24 dhe 25 qershor 2020**, kurse listat ranguese me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen me **26 qershor 2020**.

Paraqitja dhe regjistrimi i tretë i nxënësve kryhet me **29 qershor 2020**, kurse listat ranguese me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira do të publikohen me **30 qershor 2020**.

Gjatë paraqitjes për regjistrim, nxënësit kanë për obligim t'i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- **fletëparaqitje për regjistrim** (fletëparaqitjen për regjistrim nxënësi e mer nga shkolla ose e shkarkon nga web faqja e shkollës dhe e sjell të plotësuar në shkollë*)
- **dëftesa origjinale prej klasës së VI deri klasën e IX;**
- **diploma, (nëse posedojnë)** nga vendet e fituara (I, II и III) prej garave ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amëtare, gjuhë të huaj, shkenca natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe lëndë mësimore të rëndësishme të lëmisë së zgjedhur;
- **çertifikatën e lindjes** (original ose kopje e verifikuar në noter, pa mare parasysh datën e lëshimit).

VËREJTJE: Gjatë dorëzimit të dokumenteve për regjistrim, e obligueshme është prezenca e nxënësit, prindit respektivisht tutorit të nxënësit.

Gjatë regjistrimit duhet të respektohet – Protokoli i sjelljes në shkollat e mesme gjatë regjistrimit të nxënësve në vitin e parë shkollor 2020/2021.

Regjistrimi fillon në ora 07:00 dhe zgjat deri ora 19:00.

Për informata më të detajuara rreth regjistrimit vizitoni web faqen e shkollës www.dimitarvllahov.edu.mk

*Fletëparaqitjet sipas drejtimeve dhe profileve gjenden në web faqen e shkollës www.dimitarvllahov.edu.mk, në pajtueshmëri me zgjedhjen tuaj mund t'i shkarkoni dhe të plotësuar ta sjellni gjatë regjistrimit.